


PËRMES DIALOGUT, FAMILJET SERBE DHE SHQIPTARE E TË
ZHEDUKURVE KANË TEJKALUAR PARAGJYKIME DHE STEREOTIPA

NJË DHIMBJE KEMI

Beograd , mars 2024

KU JANË ?

Sipas të dhënave të KNKK-së, në mars të vitit 2024, lista e të zhdukurve në Kosovë ende përmban emra të 1618 personave



NJË RRUGË E GJATË DHE KËMBËNGULËSE NGA URREJTJA DERI NË MIRËKUPTIM TË NDËRSJELLË

Publikimi botohet nga Shoqata e Familjeve të Viktimave të Kosovës me mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Autor : Gordana Gjikanoviq

Kryeredaktor: Jelena Vujnoviq

Gazetarë-bashkëpunëtorë : Divna Shqepanoviq

Ivan Gjikanoviq

Përkthim në gjuhën shqipe/angleze : TRN Translations

Tirazh : 2000 kopje falas

Dizajn, përgatitje dhe shtyp : Inovatic wolf



Financing
European Union

(*Ky material është krijuar me ndihmën e projektit „Mbështetja e Bashkimit Evropian për Ndërtimin e Mirëbesimit në Ballkanin Perëndimor“, i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Përmbajtja e këtij Publikimi është përgjegjësia ekskluzive e Shoqatës së Familjeve të Viktimave të Kosovës dhe nuk reflekton detyrimisht qëndrimet e Bashkimit Evropian dhe as të UNDP-së)





NGA MOSKUPTIMI DERI NË DHEMBSHURI PËR TË GJITHA VIKTIMAT

KUSH DO, E GJEN MËNYRËN, KUSH S'DO, E GJEN JUSTIFIKIMIN. FAMILJET
SERBE DHE SHQIPATRE TË TË ZHDUKURVE E KANË GJETUR MËNYRËN



PAS SHUMË VITESH MOSTOLERANCË, ME MIRËKUPTIM DHE BASHKËPUNIM E GJETËM MËNYRËN PËR TË VEPRUAR SË BASHKU

Që dhjetë vjet pas zhdukjeve dhe rrëmbimeve të para të dhunshme të civileve në Kosovë – para, gjatë dhe pas konflikteve të armatosura, në atë çmenduri nga fundi i viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar, familjet e civilëve të vrarë pa faj e përballonin vetë dhimbjen dhe dëshpërimin ashtu siç dinin dhe mundnin. Familjarë të mbetur vetëm, pavarësisht përkatësisë kombëtare dhe etnike, u bënë robër dhe pengje të paragjykimeve dhe stereotipave për fajin kolektiv të “atyre të tjerëve”. As nuk kanë pasur dhembshuri për fqinjët e deridjeshëm të fesë apo kombësisë tjetër të cilët, njësoj si të afërmit e vetë, u rrëmbyen me dhunë dhe u zhdukën pa gjurmë, as nuk e kanë pranuar faktin që, në fakt, një dhimbje kanë.

Të thyer nga dhimbja, nuk e kanë menduar që janë të rënda si plumb edhe lotët e nënës që i është zhdukur djali, edhe dhimbja e fëmijës për prindin që nuk është më, edhe vuajtja e motrës së mbetur pa vëlla. Për dhjetë vite të gjata, askush nuk u thoshte që çdo viktimë dhe çdo kriminel kanë emër dhe mbiemër dhe se kur kryhen krime mbi civilë, nuk ekzistojnë dy anë. Nuk ka të tanë dhe të tyre, por ka vetëm njerëzore dhe jonjerëzore.

Duke gjurmuar pa sukses për të pagjeturit dhe vendet ku ndodhen mbetjet e më të afërmeve të tyre, familjarët nga të gjitha komunitetet etnike po gërmonin thellë e më thellë llogoret e urrejtjes, duke parë njëri-tjetrin „përmes tytës“. Të gjithë familjarët e pikëlluar të viktimave i lidhte një trishtim i përjetshëm, dhimbje dhe traumë të cilat do t'i përcjellin gjatë gjithë jetës. Edhe pse asokohe nuk donin ta shihnin dhe ta pranonin zhgënjimin dhe pakënaqësinë e barabartë me organet dhe institucionet në Prishtinë dhe Beograd, si dhe me komunitetin ndërkombëtar që nuk është marrë në mënyrë profesionale dhe përgjegjëse me çështjen e të zhdukurve dhe procedimin e krimeve të luftës. Rezultati i mosveprimit të tyre ka qenë rënia nga viti në vit e numrit të zhvarrosjeve dhe identifikimeve të të gjithë të zhdukurve në Kosovë, ndërsa procedime për krimet ndaj Serbëve dhe joshqiptarëve pothuajse nuk ka pasur fare.

Të udhëhequra nga përvojat nga rajoni dhe më gjerë, institucionet dhe organizatat ndërkombëtare me reputacion, kane identifikuar pamundësinë e shoqatave të civilëve të zhdukur dhe të vrarë nga të gjitha komunitetet etnike për të ndikuar në mënyrë të pavarur në përsheptimin e proceseve të gjetjes së të zhdukurve dhe të tregojnë shkeljet e të drejtave të tyre njerëzore më elementare. Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK), UNMIK, UNDP, Fondi për të Drejtë Humanitare, Fondacioni për Shoqërinë e Hapur, Nismat Qytetare, Integra.... udhëhoqën dhe shoqëruan familjet e të zhdukurve nëpër procesin e ballafaqimit me të vërtetën. Kjo është një rrugë e gjatë. Është një rrugë që çon drejt mirëkuptimit më të mirë, mirëbesimit dhe pajtimit të pjesëtarëve të palëve dikur në luftë. Dhe më e vështira është pajtimi i atyre familjarët e të cilëve janë rrëmbyer dhe vrarë. Organizatat në fjalë kanë organizuar dhjetëra takime, tryeza të rrumbullakëta tematike, konferenca, punëtori...

para parlamentarëve, në institucionet dhe ambasadat në Prishtinë, Beograd, rajon dhe qytete evropiane që merren me çështjen e të zhdukurve dhe të shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Rruga për t'i sjellë familjet e të pagjeturve nga të gjitha komunitetet etnike në autobus apo aeroplan të njëjtë, në sallë të njëjtë, në tryezë të njëjtë ishte plot me gjemba, shpeshherë e shoqëruar nga konfliktet verbale, moskuptimi dhe mosrespektimi nga të gjithë palët ndërsa nuk dukej të kishte gjasa që, fillimisht, do të mund ta respektonin dhimbjen e bashkëvuajtësve të tyre “nga krahut tjetër”. Të shohin se, cilado fe apo komb qofshin, i lidh i njëjti fat i lig. Në sallat e takimeve rrinin të ndarë, njëri përballë tjetrit dhe duke komunikuar vetëm brenda grupeve të tyre. Gjatë pushimeve i shihnin shtrembër “ata të tjerë” duke mos e fshehur mostolerancën, ndonjëherë duke drejtuar fjalët e këqija dhe duke e fajësuar njëri-tjetrin se janë përgjegjës dhe ata si popull, që fëmijët, prindërit, vëllezërit dhe motrat, bashkëshortët... janë zhdukur me forcë ose janë vrarë në mënyrë tinëzare dhe pa iu ditur varri.

Dhe pas dhjetëra takimesh dhe mbledhjesh të organizuara mes përfaqësuesve të familjeve serbe dhe shqiptare të viktimave, dukej sikur ata kurrë nuk do të kenë as vullnet e as nevojë për t'u mirëkuptuar me njëri-tjetrin. Të dëgjojnë me vëmendje dhe nderim dhe të pranojnë faktin që krimet nga më të tmerrshmet janë bërë nga të dyja anët. Që kanë vdekur pleq, të pafuqishëm, gra, fëmijë nga të gjitha komunitetet etnike dhe se po aq trishtim dhe dhimbje për më të afërmit e tyre ndiejnë dhe mbartin Natasha, Bajrami, Marinko, Gjyla, Negovan, Sevda dhe tashmë i ndjeri Milorad Trifunoviq. Të gjithë atyre u dukej po aq i largët mendimi që në fakt ata i ndërlidh mospërballimi, vuajtja dhe dëshpërimi. Dhe janë po aq të pakënaqur me autoritetet, institucionet vendase dhe ndërkombëtare si dhe organizatat që dështuan në provimin e humanitetit. Sepse nuk kanë bërë gjë me vite të tëra, ose kanë bërë shumë pak për t'u kthyer dinjitetin viktimave të pafajshëm dhe për të rregulluar në mënyrë sistematike të drejtat e familjeve të tyre.

Me kalimin e kohës, gjatë takimeve dhe mbledhjeve, marrëdhëniet dhe komunikimi ndërmjet familjarëve serbë dhe shqiptarë filluan të ndryshonin, gjë që ishte e pritshme për disa, e për disa jo. Filluan t'i japin dorën njëri-tjetrit, të rrinë pranë njëri-tjetrit dhe të komunikojnë me gjuhën e fqinjëve të tyre të cilën e kishin harruar pothuajse. Të tregojnë empati për viktimat e tjera gjatë procesit të ballafaqimit me të kaluarën dhe të të folurit publik dhe dëshmimit për vuajtjet e të afërmit të tyre, si dhe të tregojnë publikisht mirëkuptim dhe nderim për bashkëvuajtësit e fesë dhe kombësisë tjetër. Këmbëngulja në përafrimin e familjeve serbe dhe shqiptare të të zhdukurve, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve - ICMP, KNKK, UNMIK, UNDP, Fondi për të Drejtë Humanitare, Nismat Qytetare... çoi në realizimin e ideve të tyre. Janë mposhtur paragjykimet dhe stereotipat. Me një formë të vetme të pranueshme - dialog, duke respektuar vuajtjen dhe dhimbjen e „atyre të tjerëve“, vjen mirëkuptimi më i mirë i cili është rruga e duhur drejt vlerësimit të ndërsjellë, dhe, besoj, pajtimit.

Para nja dhjetë vitesh, organizatat e përmendura ndërkombëtare ua kanë lënë në dorë shoqatave të familjeve serbe dhe shqiptare të viktimave civile që të bien dakord vetë, të zgjedhin dhe të përcaktojnë vazhdimin e bashkëpunimit përmes aktiviteteve dhe veprimeve të përbashkëta ndaj autoriteteve dhe institucioneve në Beograd dhe Prishtinë. Dhe sidomos ndaj komunitetit ndërkombëtar. Këto organizata kanë mbetur pranë familjeve të viktimave të cilat i mbështesin dhe i ndihmojnë financiarisht deri më sot në aktivitetet e tyre.

Jordana Dikavovic

KUJTIMI I KRIMEVE SI PARALAJMËRIM QË KJO KURRË NUK DUHET T’I NDODHË MË ASKUJT

Gjatë viteve 1998, 1999 dhe 2000 në konfliktet në Kosovë janë vrarë dhe zhdukur pa gjurmë mijëra civilë - kryesisht të pafuqishëm. Krimet i kanë bërë jonjerëz nga të dyja anët e konfliktuara. Çdo krim, qoftë zhdukje me forcë apo vrasje, qoftë masiv apo individual, mbetet i papërballueshëm për gjithë jetën. Dhe secili është i dhimbshëm, i rëndë, i mundimshëm... Pa shpjegim se përse kanë mbetur familjet e tyre pa më të afërm të tyre kur as ata dhe as familjet e tyre s’i kanë bërë keq askujt.

Në Kosovë kanë humbur jetë mijëra civilë, dhe çdo krim është po aq i rëndë, po aq i ngjashëm por edhe i ndryshëm në mënyrën e tij. Sa i rëndësishëm është ballafaqimi me të vërtetën dhe advokimi publik - të folurit për krimet e kryera nga jonjerëz, tregohet nga fakti që pikërisht tregimet tronditëse të treguara publikisht në ambientet ku rrinë së bashku familjarët serbë dhe shqiptarë të të zhdukurve, kanë zgjuar dhembshuri dhe empati dhe u kanë çuar lot në sy të gjithëve, të çfarëdolloj kombësie apo feje qofshin.

Duke respektuar njësoj çdo viktimë, do të japim vetëm shembuj të vrasjeve masive të familjeve Shutakoviq nga Gjakova dhe Bogujevci nga Podujeva.

Shuhet e gjithë familja Shutakoviq në Gjakovë

Më 10 shtator të vitit 2019 në Andrijevicë janë varrosur mbetjet mortore të familjes pesëanëtarëshe Shutakoviq - babai Nedeljko (63), nëna Darinka (58) dhe fëmijët Aleksandar (17) Gjorgje (15) dhe Radoman (10), të rrëmbyer nga pjesëtarët e së ashtuquajturës UÇK më 12 qershor të vitit 1999 në Gjakovë, dhe të ekzekutuar më pas. Mbetjet e tyre janë gjetur në lokacionin “Bunker” në rrethinën e Gjakovës, dhe njëkohësisht ky ka qenë lokacioni i fundit i kërkuar deri më sot, ku janë gjetur mbetjet e shtatë Serbëve të zhdukur. Kërkimi i nëntë lokacioneve potenciale të dorëzuara nuk është bërë deri më sot. Bëhet fjalë për: Kosharë, Llapushnik të Gllogocit, Dojnicë të Prizrenit, Javor të Suharekës, Llugë të Istogut, Budisalcë dhe Balevc të Klinës, Liqen të Livoqit afër Gjilanit dhe Mejë të Gjakovës.

Gjorgje dhe Darinka si dhe tre djem të tyre të mitur - Aleksandar (17), Gjorgje (15) dhe Radoman (10) Shutakoviq u rrëmbyen më 12 qershor të vitit 1999 në Gjakovë. Mbetjet e tyre mortore janë gjetur në lokacionin “Bunker” në Gjakovë, ndërsa forenzikët kanë përcaktuar se vdekja ka ardhur si pasojë e ekzekutimit. Ata u varrosën më 10 shtator të vitit 2019 në varrezat e Andrijevicës në Mal të Zi dhe ceremonia mortore u mbajt nga peshkopi Joanikije.

Frymëzuesit, urdhëruesit dhe autorët e këtij krimi makabër nuk janë gjetur deri më sot. Kjo është vetëm një nga njëqind krime masive të kryera ndaj Serbëve të Kosovës, që ka mbetur pa u dënuar.

Familja pesëanëtarëshe Shutaković jetoi në banesën e tyre në qendër të Gjakovës. Kishin një jetesë modeste por të lumtur, në marrëdhënie të mira me fqinjët, kryesisht Shqiptarë. Dhe kur Serbët nga Gjakova dhe rrethina u dëbuan nga shtëpitë e tyre dhe u nisën në të panjohur, në drejtim të Serbisë qendrore ose në Mal të Zi, Shutakovićët mbeten në qytetin e tyre. Dhe për fat të keq, rezultoi se kanë gabuar. Në mes të ditës në banesën e tyre kanë hyrë njerëz të armatosur deri në dhëmbë me uniforma të UÇK-së. U kanë lidhur duart me tel, duke i shtyrë nga banesa dhe duke i çuar në njërin nga disa kampe për Serbët në Gjakovë. Marrja e tyre me forcë nga banesa iu raportua KFOR-it nga një komshie Shqiptare që pinte kafe me Darën çdo mëngjes. Edhe fëmijët e tyre shoqëroheshin dhe shkonin bashkë në shkollë.

Njëzet vjet pas zhdukjes me forcë të gjithë familjes Shutaković, mbetjet e tyre mortore janë varrosur në varrezat e Andrijeviçës në Mal të Zi. Sot në Gjakovë nuk ka më Shutaković të gjallë. Pas shkatërrimit dhe devastimit të varrezave ortodokse në Gjakovë, nuk ka më gjurmë se Shutanovićët kanë jetuar ndonjëherë në këtë qytet.

Kujtimet e dhimbshme të Saranda Bogujevci

Më 28.03.1999 rreth orës 10 në Podujevë u krye një krim ndaj familjes Bogujevci. Për këtë krim ka folur gjatë konferencës së ballafaqimit me të vërtetën të organizuar nga Fondi për të Drejtë Humanitare, e mbijetuar Saranda Bogujevci e cila ishte katërmëdhjetë vjeçe në kohën kur është kryer krimi. “Akrepat” morën Shpëtimin (10), Shpenden (13), Salën (39), Norën (15), Shefkaten (43), Shehiden (67).

Mbijetuan pesë fëmijë të lënduar, Saranda 1985, Fatosi 1986, Jehona 1988, Lirie 1990 dhe Genci 1993. 75 vjet burg “Akrepave” për krimin në Podujevë

Para Këshillit për Krimet e Luftës së Gjykatës së Rrethit në Beograd janë dënuar me gjithsej 95 vjet burg pesë anëtarë të grupit “Akrepat” për vrasje të katërmëdhjetë civilëve në Podujevë.

Një nga dëshmitë më tronditëse për shuarjen e gati gjithë familjes Bogujevci nga Podujeva në konferencën për drejtësinë tranzicionale dhe domosdoshmërinë e ballafaqimit me të vërtetën në kuadër të nismës për KOMRA, familjet e të zhdukurve në rajon, e dha Saranda Bogujevci. Saranda, sot një grua e re dhe e suksesshme. Në moshën 14 vjeçe, për fat të madh, ajo ka mbijetuar masakrën e kryer nga “Akrepat” ndaj familjes së saj dhe të xhaxhait të saj. Teksa po dëshmonte për vrasjet dhe plagosjet e më të afërmeve të saj, në sallë po dëgjoheshin rënkime. Saranda dhe katër fëmijë të tjerë - vëllezër dhe motra, ishin të lënduar rëndë. “Akrepat” nuk e kthyen kokën pas duke menduar se i kishin kositur të gjithë me breshëri plumbash. Pas operacioneve të shumta dhe të vështira jashtë vendit, ata të pesë vazhduan me jetët e tyre me frikë dhe traumë sepse e kishin parë vdekjen në sy, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Dhe kanë parë gjithashtu trupat e pajetë të nënës, vëllezërve dhe motrave të tyre, të shtrirë pranë tyre në oborr.

Duke dëgjuar këtë dhe histori të tjera, dëshmi për vuajtjet e më të afërmeve të tyre, familjarët e viktimave nga të gjitha komunitetet etnike kanë mësuar të dëgjojnë njëri-tjetrin, të bashkëndiejnë në dhimbjen e tyre, të kuptojnë më mirë njëri-tjetrin... Ta kuptojnë me kalimin e kohës se sa të ndërlydhura janë fatet e tyre. Sepse dhimbjen, trishtimin, traumat dhe dëshpërimin... e kanë po aq të rëndë dhe po aq të madh. Kjo ishte ajo fija primordiale që ka lidhur familjet serbe dhe shqiptare.

**DUKE DËGJUAR MË TË ARSYESHMIT
DHE DUKE MËSUAR NGA ATA,
ANËTARËT E RINJ TË SHOQATËS U PËRFSHINË NË
LUFTIM PËR GJETJEN E TË GJITHË TË ZHDUKURVE**



Ylber Morina, Zyrtar i Lartë i Programi të Nismave të Shoqërisë Civile të Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur:

NGA MONOLOGËT E NDEZURA DERI NË DIALOG KONSTRUKTIV

Nga viti 1999 Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) punon në zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur si pasojë e konfliktit në Kosovë. ICMP ka vendosur të nxisë dhe inkurajojë autoritetet dhe institucionet në Prishtinë dhe Beograd që të përshpejtojnë procesin e gjetjes së të zhdukurve dhe të ndihmojnë familjet në realizimin e të drejtave të tyre. ICMP jep kontribut të madh edhe duke u përfshirë në procesin e identifikimit të personave përmes analizës së ADN-së nga viti 2003 me UNMIK-un dhe më vonë me Departamentin e Mjekësisë Ligjore të EULEX-it, si dhe së fundmi me Institutin e Mjekësisë Forenzike.

Familjet e të zhdukurve kanë rolin kyç në procesin e gjetjes së personave të zhdukur gjatë dhe pas konflikteve. Jo vetëm se angazhimi i familjeve është i domosdoshëm për procesin e identifikimit të bazuar në analizat e ADN-së, por është po aq jetik në kuptimin e thirrjes së autoriteteve në përgjegjësi nga pikëpamja e kërimit për identifikimin e të gjithë personave të zhdukur. E kemi kuptuar rëndësinë e mundshme të të vepruarit dhe të aktiviteteve të përbashkëta të përfaqësuesve të familjeve serbe dhe shqiptare në këtë proces, duke besuar se daljet e tyre të përbashkëta do të kenë jehonë.

Megjithatë, ky proces i të vepruarit së bashku të familjeve serbe dhe shqiptare në Kosovë nuk ka qenë aspak i lehtë. ICMP në vitin 2006 nisi projektin e “Ballafaqimit me të kaluarën” për përfaqësuesit e shoqatave të familjeve serbe dhe shqiptare të të zhdukurve në Kosovë dhe në Serbi. Ideja ishte që të organizohej një punëtori me temat e njëjta të Ballafaqimit me të kaluarën, veç e veç për përfaqësuesit serbë të të zhdukurve dhe për ata shqiptarë. Me qëllim që të organizohet një punëtori e përbashkët në të ardhmen e afërt, me përfaqësues të Serbëve dhe të Shqiptarëve në të cilën ata do të bisedonin bashkë për shqetësimet e tyre dhe në mënyrë që kërkesat e familjeve të kenë më shumë fuqi në drejtim të institucioneve kompetente për zbardhjen e fateve të më të afërmeve të tyre.

Nuk u befasuam që të dyja palët gjatë punëtorive, edhe Serbët edhe Shqiptarët, ishin kundër çfarëdolloj takimi të përbashkët, “duke ia vënë fajin palës tjetër për tragjedinë familjare”.

Në maj të vitit 1999, ICMP bashkë me Akademinë Nansen organizoi punëtorinë “Dialogu ndëretnik” në Lilehamer të Norvegjisë, ku morën pjesë nga pesë përfaqësues të familjeve serbe dhe shqiptare. Organizimi logjistik i udhëtimit ishte jashtëzakonisht i vështirë. Familjarët nuk donin të udhëtonin bashkë deri në aeroport. Në aeroport grupet rrinin plotësisht të ndara dhe neve, si organizatorë, na duhej ti ndiqnim njëkohësisht edhe Serbët edhe Shqiptarët. U detyrova të vrapoja nga cepi në cep të

aeroportit. Sfida e radhës erdhi gjatë takimeve, ku emocionet e çdo përfaqësuesi ishin të mëdha, të shoqëruara nga akuzat ndaj palës tjetër. Prapë se prapë, pash shtatë ditësh qëndrim në Norvegji, përfaqësuesit e familjeve serbe dhe shqiptare filluan të kuptonin se kanë një dhimbje të përbashkët, dhe që po vuajnë njësoj për më të dashurit e tyre, sido që të quhen ata. E kanë njohur shqetësimin dhe gjendjen e pashpresë të të gjithë të pranishmëve, si dhe pakënaqësinë me mosveprimin e institucioneve dhe organizatave vendase dhe ndërkombëtare në drejtim të gjetjes së të gjithëve nga lista e integruar e të zhdukurve në Kosovë. Si rezultat, harmonizua, pranua dhe morëm Konkluzione të përbashkëta dhe ua kemi dërguar ato zyrtarëve të shteteve më të fuqishme të botës, si dhe zyrës së OKB-së në Njujork.

Takimet e përbashkëta kanë vazhduar edhe në vitet në vijim, deri më sot, duke organizuar punëtori të përbashkëta, tryeza të rrumbullakëta tematike, shënime të përbashkëta të Ditës Ndërkombëtare të të Zhdukurve në Prishtinë dhe Beograd, konferenca për shtyp... me prezencën e gjithnjë e më shumë familjarëve të të zhdukurve.

Megjithatë, një numër i caktuar i përfaqësuesve të shoqatave të familjeve janë ende kundër aktiviteteve të tilla të përbashkëta dhe kjo përbën një sfidë për rritjen e numrit të përfaqësuesve të familjeve serbe dhe shqiptare të viktimave civile në lobim të përbashkët ndaj të gjitha institucioneve vendase dhe ndërkombëtare përgjegjëse për procesin e zbardhjes së fateve të të zhdukurve.

Si dhe deri tani, ICMP do të vazhdojë të mbështesë dhe të ndihmojë angazhimin dhe aktivitetet e përbashkëta të shoqatës si dhe të familjeve të të zhdukurve nga të gjitha komunitetet etnike në Kosovë, sepse mendojmë që familjet janë më të dukshme dhe më forta në këtë rrugëtim drejt realizimit të qëllimeve të tyre.



KEMI TË DREJTË TË DIMË

Takimi në Ohër

Një nga takimet e para të përbashkëta të familjeve serbe dhe shqiptare të personave të zhdukur, i organizuar në Ohër, ka qenë i diskutueshëm dhe pa shumë pritje. Pasojat e konfliktit në Kosovë ishin tepër të mëdha për të dy palët të kundërshtuara që të mund të mblidhnin forcë për të komunikuar normalisht dhe për ta parë njëri-tjetrin në sy si dikur.

Ne kemi jetuar pranë njëri-tjetrit me shekuj, duke ndarë të mirën dhe të keqen, duke pranuar dhe respektuar diferencat dhe ndarjet... Pastaj erdhën konfliktet... Në Kosovë ishte ndezur një zjarr që po përhapej gradualisht, duke përfshirë pjesën më të madhe të asaj zone. Në këtë zjarr konfliktesh, për fat të keq, mbizotëruan urrejtja, ligësia dhe terrori.

Është e vështirë të maten me saktësi të gjitha përmasat e vuajtjes dhe e gjithë sasia e fatkeqësisë dhe ligësisë, të tmerreve dhe makabriteteve. U takuam në Ohër sepse nga të dyja anët kishim persona të zhdukur dhe familjet e tyre të cilat ishin duke i kërkuar ata. Për shumicën prej tyre ky kërkim po zgjat deri në ditët e sotme. Jemi takuar me ndërmjetësinë e Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) i cili ka qenë nxitës dhe organizator i takimit të përbashkët. Kishim një rend dite dhe na u dha mundësia për të dhënë komentin tonë, ose t'u bëjmë pyetje përfaqësuesve të institucioneve dhe organizatave kompetente. Kishte ligjërata të ndryshme. Të gjitha ato përmbanin në vete mostolerancë, dhimbje, trishtim, gjykim. Ata akuzonin udhëheqjen e Serbisë, ushtrinë dhe policinë, ndërsa ne akuzonim pjesëtarët e UÇK-së, KFOR-it dhe UNMIK-ut...

Gjatë takimeve si dhe gjatë pushimeve, rrinim të ndarë në dy grupe. Ata në njërin grup, ne në tjetrin... Kishte tentativa individuale të përafrimeve me dëshirën për të bërë ndonjë pyetje ose për të kërkuar ndonjë informacion.

Unë u ndjeva e pafuqishme, e trishtuar dhe e zhgënjyer... Zemra ime e plagosur e kishte shumë të vështirë... Vetë idenë që erdhëm në Ohër dhe se nuk mund të shkojmë në shtëpitë tona, në vendlindjen tonë, por e anashkalojmë atë, e mora shumë vështirë. U kisha zili sepse të gjithë ata u kthyen në shtëpitë e tyre, ndryshe nga ne që shumica po ktheheshim në adresa dhe vendbanime të reja...

Ishin të zemëruar me ne, dhe unë u ndjeva sikur ne kishim më shumë arsye për të qenë të pakënaqur dhe të hidhëruar. U ndamë diqysh, të vetëdijshëm për faktin që marrëdhëniet tona nuk do të jenë më si dikur. Është tepër e vështirë të mbash në shpirt dhe zemër këtë barrë të pasluftës, por duhet të ecim para. Duhet të jemi këmbëngulës në luftën tonë të drejtë për të vërtetë dhe drejtësi, për shkak të viktimave tona të pafajshme dhe për shkak të së ardhmes së gjeneratave të ardhshme.



Shënimi i përbashkët i Ditës Ndërkombëtare të të Zhdukurve, Beograd 2022

Zgjidhja e çështjes së të zhdukurve është një çështje e rëndësishme humanitare, ligjore dhe morale. Nga zgjidhja e saj kryesisht varet edhe procesi i pajtimit dhe të ndërtimit të shoqërive multietnike të cilat do të ndërtoheshin mbi themelet e demokracisë, sundimit të ligjit dhe tolerancës së ndërsjellë. Kërkojmë mbrojtje të të drejtave tona në të gjitha format. Së pari, e drejta për të mësuar për fatet e të afërmeve tanë dhe e drejta për varrim të denjë të të gjithë të zhdukurve dhe të vrarëve nga të gjitha komunitetet etnike në Kosovë. Pas advokimeve dhe përpjekjeve të mëdha shumëvjeçare për të ndikuar, si familjet e të zhdukurve, në përshpejtimin e procesit të gjetjes së të gjithë të rrëmbyerve, nuk jemi të kënaqur me arritjet. Dhe kemi bërë gjithçka brenda mundësive tona që të jetë ndryshe.

U shndërruam në ligjërues, pjesëmarrës, ndërmjetës, prezantues.... Edhe pse s' e deshëm atë. Sepse i vetmi qëllim i yni ka qenë marrja e përgjigjeve të pyetjeve kush, pse, ku dhe si... Të gjithë ne duam të gjejmë fëmijët, prindërit, vëllezërit, motrat, miqtë dhe komshinjtë tanë. Dhe prandaj, edhe pas 23 vitesh nga përfundimi i konflikteve në Kosovë, kërkojmë përgjegjësi, vendosmëri, guxim, humanitet, paanshmëri dhe efikasitet të punës së të gjithë faktorëve relevantë, kërkojmë dhembshuri dhe njohje. Po na sjellin nëpër projekte, punëtori edukative, forume, drejtësi tranzicionale, takime, tubime, për të na vënë në punë dhe për të na zënë në mënyrë dinake këto pak mendtë e kokës që na kanë mbetur, që të shpërfillim paragjykime dhe stereotipa, që të përballojmë veten tonë.

Bajram Qerkinaj, Mitrovicë

TË ZHDUKURIT, BRENGA E ASKUJT

Takimet me familjet e të zhdukurve në Kosovë, nga viti 2006 e deri në vitin 2010 janë mbajtur në të gjitha qendrat e pushtetit, pa asnjë efekt të dukshëm.

Edhe para përfundimit të konflikteve të armatosura në Kosovë, familjet e të zhdukurve me forcë kishin filluar vetë t'i kërkonin të zhdukurit e tyre, dhe më pas janë organizuar në shoqata qëllimi i të cilëve ka qenë gjetja dhe varrimi i denjë i të gjithë personave të zhdukur. Me kalimin e kohës e kuptuam që kjo çështje humanitare duhet të trajtohet nga autoritetet dhe institucionet vendase dhe ndërkombëtare. Atyre u drejtoheshim për ndihmë ditë për ditë, duke e ditur që në fillim se fuqia dhe e vërteta janë në duart e tyre. Se ata, në varësi të kompetencave dhe detyrave të tyre, kanë qasje në raporte, procesverbale, fotografi, imazhe satelitore... Si atëherë, si sot, nuk e kam të qartë se pse e fshehin të vërtetën nga ne, duke ia kaluar përgjegjësinë njëri-tjetrit. Mungesa e interesimit dhe e vullnetit për të gjetur të gjithë të zhdukurit na ktheu drejt organizatave ndërkombëtare të cilat merren me të zhdukurit dhe shkeljet e të drejtave të njeriut, ambasadave dhe atyre që marrin vendimet më të rëndësishme në botë. Të çmendur prej dhimbjes dhe trishtimit për vitet që po kalojnë,

ndërsa numri i ekshumimeve dhe identifikimeve po ulet, kërkuam dhe apeluam që të na ndihmojnë. Takimet e para me familjet e të zhdukurve nga të gjitha komunitetet etnike u organizuan nga Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP). Edhe pse jam mirënjohës për ndihmën dhe mbështetjen e tyre, që nga fillimi kam dalë kundër organizimit individual të takimeve, mbledhjeve dhe tryezave të rumbullakëta - së pari me familjet shqiptare, pastaj me ato serbe. E kam ditur dhe e kam thënë publikisht që kjo nuk është rruga e duhur drejt ballafaqimit me të kaluarën dhe përmirësimit të mirëkuptimit reciprok. Kam insistuar që grupet të jenë të përziera, të shikojmë njëri-tjetrin në sy, të nxjerrim nga vetja urrejtjen, mllëfin, mosmarrëveshjen dhe moskuptimin që njësoj po vuajmë të gjithë. Si dhe të tjerët, edhe unë e ndjeva që plagët tona ishin ende të freskëta, që zemrat po na rrjedhin gjak dhe se nuk e pranojmë që krimet janë bërë nga të dyja anët... Kurse e vetmja e vërtetë është që ka vetëm njerëz të mirë dhe të këqinj. Ata të ligët që kanë mbështjellë familjet tona në dhimbje dhe trishtim, të verbuar nga urrejtja që na turbullon mendjen dhe dhimbja me të cilën po jetojmë sot e kësaj dite. Në fillim, disa ndër Serbë dhe Shqiptarë nuk donin të hynin në njëjtën sallë apo dhomë. Dhe jo më të flasin me njëri-tjetrin. Me kujtohet në veçanti një qëndrim shtatëditor të familjeve serbe dhe shqiptare të të zhdukurve në Norvegji në pranverë të vitit 2007, sikur të ishte dje. Më kujtohet kur po hynim në një sallë të madhe ku duhej të bisedonim për temën: Pse jemi këtu? Ishim të ndarë në dy grupe dhe pyetja ime e parë ishte: Pse jemi të ndarë këtu? Kërkova nga organizatori që mos të na shohin vetëm si Shqiptarë dhe Serbë, sepse të gjithë kemi të njëjtin problem, kërkojmë më të afërmit tanë që janë zhdukur gjatë luftës. Trifa (i ndjeri Millorad Trifunoviq) që ishte ulur pranë meje, më përqafoi dhe filloi të qante, dhe edhe pse shumica nuk na kuptonin, ne të dy vazhduam betejën e gjatë dhe të vështirë që të gjendet çdo Shqiptar dhe Serb, deri te i fundit. Në këtë takim, si dhe në shumë takime të tjera që pasuan, jemi marrë gjatë me harmonizimin e konkluzioneve tona të përbashkëta të cilat ua dorëzonim autoriteteve në Prishtinë dhe Beograd, si dhe përfaqësuesve të misioneve ndërkombëtare në Kosovë. Përgjigjet, kryesisht, nuk i merrnim.

Me ndihmën e ICMP-së, UNDP-së, ambasadës britanike dhe organizatave të BE-së që kanë identifikuar përparësitë e angazhimit të përbashkët të familjeve shqiptare dhe serbe të të zhdukurve, gjatë dhjetë viteve të fundit disa prej shoqatave shqiptare dhe serbe të familjeve të viktimave janë duke organizuar aktivitete të ndryshme të përbashkëta në mënyrë të pavarur. Disa prej familjeve të viktimave, madje dhe sot, nuk e kuptojnë dhe nuk e mbështesin angazhimin tonë të përbashkët, por ne jemi të sigurtë që jemi në rrugën e duhur drejt mirëkuptimit të ndërsjellë. Në takimet e ndryshme të shoqatave serbe dhe shqiptare të familjeve të civilëve të zhdukur dhe të vrarë kemi arritur në konkluzion të përbashkët që komuniteti ndërkombëtar dhe lokal nuk e marrin seriozisht çështjen e të zhdukurve. Gjatë konflikteve në Kosovë nuk është bërë kurrëgjë që vendet që kanë pasur ushtarë atje nuk e dinë. Sot e kësaj dite politikanët na mbajnë peng sepse ata mund të shtyjnë këtë proces edhe në Beograd edhe në Prishtinë, por edhe përfaqësuesit ndërkombëtar na kanë borxh shumë sepse kanë imazhe satelitore. Në secilin prej takimeve të përbashkëta të familjeve shqiptare dhe serbe të të zhdukurve dhe të vrarëve, i bëjmë pyetje vetës vazhdimisht se si ka mundësi, që me gjithë këtë teknologji moderne ku çdo pjesë e Kosovës është inçizuar me satelit, të zhdukurit nuk mund të gjenden edhe pas çerek shekulli. Të gjithë udhëheqësit dhe institucionet evropiane dhe botërore duhej ta kishin kuptuar që çështja e të zhdukurve do të jetë çështja më e rëndësishme sot dhe në vitet e ardhshme, jo vetëm për familjet. Nëse në të vërtetë synohet pajtimi në rajon.

Marinko Gjuriq, Istog:

TË GJITHË JEMI HUMBËS TË KONFLIKTEVE TË VITEVE NËNTËDHJETË

25.10.2007

Për rëndësinë që politikanët e caktuar në rajon i kanë kushtuar çështjes së të zhdukurve dhe të procedimit të krimeve të luftës, më së mirë flet fakti që takimi multietnik në Novi Vinodolski u hap nga përfaqësuesja e atëhershme e qeverisë kroate Jadranka Kosor në prani të drejtoreshës së ICMP-së Ketrin Bomberger.

Ditën e parë të gjithë përfaqësuesit e familjeve të të zhdukurve në rajon patën mundësi të prezantoheshin për të thënë diçka më shumë mbi punën dhe aktivitetet e shoqatave të tyre. Për ditën tjetër janë parashikuar biseda të përbashkëta të familjeve të viktimave në luftërat e viteve nëntëdhjetë në zonën e ish-Jugosllavisë. Për ne si familjet e të zhdukurve nga Kosova, u parashikua që të bisedojmë në përbërje të përzier dhe në të njëjtën sallë, në prani të moderatorit nga ICMP.

Atmosfera ishte mjaft e tensionuar që në hapje, sidomos midis Serbëve dhe Shqiptarëve sepse Kosova nuk ishte përfaqësuar si Republika e Kosovës por vetëm si Kosovë nën administratën e OKB-së. Për këtë kanë insistuar organizatorët e tubimit si dhe përfaqësuesit e Komisionit të Qeverisë për Personat e Zhdukur të Republikës së Serbisë, ndërsa familjet kanë mbështetur atë qasje.

Kur u zgjidhën paqartësitë, familjet serbe dhe shqiptare vazhduan të komunikonin me njëri-tjetrin. Për herë të parë kemi dëgjuar rrëfimet e familjarëve të viktimave civile nga të gjitha komunitetet etnike në Kosovë, duke u përprjekur që të “dilnim nga llogoret ku ishim të gërmuar”. Dukej sikur asnjë nuk donte t’ia dinte dhe të pranonte që krimet janë bërë nga të dyja palët. Nuk ishim të gatshëm që ta besojmë plotësisht, por secili nga ne e njihte të paktën një që ka bërë gjëra të pandershme në zonën e tij. Por kur ke gjendje lufte, këto tipare të këqija shfaqen akoma më shumë tek njerëzit që kanë bërë të fortin me të pafuqishmit.

Këtë fat të lig e priti dhe babai im Petar, një gjashtëdhjetëenëntëvjeçar i sëmurë rëndë. Në të njëjtën shtëpi të Ljushiqëve ndodheshin dhe dhëndri i tij, Mihajlo Vuliq, një plak i palëvizshëm dhe halla ime Gjurgja. Janë vrarë gjatë natës, duke pritur që KFOR t’i transferonte të nesërmen në mëngjes drejt Serbisë qendrore.

Secilit prej nesh iu dha mundësia që të jepte dëshminë personale, duke mos e fshehur dhimbjen, vuajtjen dhe traumat që zgjasin deri më sot. Një numër i vogël i krimeve janë proceduar. Shumica prej dëshmitarëve dhe dëshmitarëve okular të këtyre krimeve nuk janë gjallë sot që do të thotë se është humbur shansi që institucionet kompetente të mbledhin, dokumentojnë, publikojnë dhe procedojnë këto krime, sepse për shumicën prej tyre nuk ka kush të flasë.

Duke e dëgjuar njëri-tjetrin, duke u ballafaquar me të kaluarën, na u dha mundësia që të kuptojmë se ka pasur viktimë të pafajshme në të dyja anët. Që nuk duhet të shikojmë krimet në mënyrë joobjektive dhe të njëanshme, por që keqbërësit të përgjigjen për veprat e tyre pavarësisht nga feja dhe kombi. E ndjeve se të gjithë ne, në fakt, jemi humbës në këto konflikte dhe se nuk ka fitues ndër ata që kanë humbur të paktën një anëtar të familjes. Këtë botëkuptim timin nuk e kuptuan të gjithë njësoj. Madja u dëgjuan edhe pyetjet “po ata çfarë na kanë bërë neve?”. Fatmirësisht, më vonë u shtuan nga të dyja anët ata që e pranonin faktin që nuk ekziston përgjegjësia dhe faji kolektiv por që çdo krim dhe çdo viktimitë kanë emër dhe mbiemër. Në mbledhje dhe takime që organizoheshin në vitet në vijim e deri më sot, vinte duke u shtuar numri i atyre që mendojmë në të njëjtën mënyrë për mosekzistencën e fajit kolektiv. Në fund të takimit në Novi Vinodolski filluam t’i themi njëri-tjetrit komshi, ashtu siç bënim deri në vitin 1999.

Gjyla Haziri, Mitrovicë:

VETËM SË BASHKU MUND TË GJEJMË TË VËRTETËN PËR TË ZHDUKURIT

Ka kaluar shumë kohë dhe shumë përpjekje nga të gjithë ne, përfaqësues të familjeve shqiptare dhe serbe të të zhdukurve, për të mposhtur urrejtjen, paragjykimet, stereotipa dhe mosmarrëveshje... U veçuam ne që jemi këtu dhe ata të cilët i përfaqësojmë, me bindjen që jemi më të fortë së bashku dhe se me angazhimin, aktivitetet dhe mesazhet e përbashkëta mund të arrijmë më shpejtë në gjetjen e të gjithë të zhdukurve. Unë them që e vërteta nuk ka anë, që kemi një qëllim dhe se duhet të vazhdojmë të punojmë dhe të veprojmë së bashku. Punën, për fat të keq, nuk e kemi kryer ende sepse në listën e integruar të personave të zhdukur ende gjenden 1620 persona. Atë që kemi filluar me kohë, do ta vazhdojmë të rinjtë, anëtarë të shoqatave tona që kanë kuptuar dhe pranuar rëndësinë e betejës sonë të përbashkët. Dhe besojmë se angazhimi i tyre do të japë rezultate më të mira sesa këto tonat.

Gordana Gjikanoviq, Prishtinë

“SIKUR BISTRICA NA E KTHJELLOI MENDJEN”

Nga viti 2006, kryesisht të organizuara nga Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, janë mbajtur rreth dhjetë takimeve të familjeve të personave të zhdukur, si në nivelin rajonal, ashtu dhe bilateral - vetëm midis anëtarëve të familjeve serbe dhe shqiptare të viktimave civile. Në vitet e para këto takime, edhe pse të konceptuara si të përbashkëta, mund të quhen ashtu pothuajse vetëm për faktin që gjatë tyre pjesëmarrësit rrinin në salla të njëjta. Rrinim të grupuar sipas kombësisë, pa pasur dëshirë për vite të tëra që të dëgjojmë dhe të kuptojmë njëri-tjetrin. As nuk përshëndeteshim, as nuk bisedonim gjatë pushimeve të takimeve, duke udhëtuar me të njëjtin transport sikur nuk merrnim pjesë në takime të përbashkëta që synonin respektin reciprok të të gjitha viktimave dhe dhembshuri për familjarët e tyre, të çfarëdolloj feje apo kombësie qofshin. Sikur nuk e ndjenim njësoj dhimbjen për më të afërmit tanë. Sikur nuk ishte dashur që në fillim që të kërkojmë dhe të gjejmë mënyrë për të përshpejtuar procesin e gjetjes së të zhdukurve, për t'u dhënë keqbërësve dënimin e merituar... për t'u bërë më të fortë në kërkesat tona... dhe të gjitha këto takime të shumta, mbledhje, punëtori - i ngjantin njëra-tjetrës. Shpeshherë e lëndonim njëri-tjetrin, dhe sikur e bënim me qëllim, reagonim vrazhdë dhe kundërshtoheshim sa herë që dëgjonim dikë të fliste gjuhën tjetër. Dhe prapë ndaheshim pa asnjë përparim të dukshëm në komunikim, duke mos e përshëndetur njëri-tjetrin fare. Dhe pastaj, si rezultat i hapave drejt mirëkuptimit më të mirë, në mars të vitit 2015 u zhvillua takimi i përbashkët në Prizren si një pikë kthese, për të cilën ne nuk ishim të vetëdijshëm ose nuk donim t'ia prananim vetes dhe të

tjerëve. Sikur Bistrica na kthjelloi mendjen dhe na i hapi sytë, dhe duke rrjedhur heshtas, na tregoi se si të vazhdojmë tutje.

Pa fjalë të rënda dhe pa kundërshtime, për herë të parë kishim rënë dakord që do të bisedonim vetëm për gjërat e përbashkëta. Dhe këto janë dhimbja dhe mospërballimi i më të afërmve tanë, si të gjejmë mënyrë për të detyruar autoritetet dhe institucionet vendase, por edhe ato ndërkombëtare, që t'i nxisim që të fillojnë më në fund të merren me çështjet e të zhdukurve dhe të procedimit të krimeve. Në vitin 2015 në Prizren, por edhe më vonë e deri më sot, e kishim të lehtë që t'i harmonizonim qëndrimet dhe konkluzionet e përbashkëta, të cilat ua përcillnim autoriteteve në Beograd dhe Prishtinë, si dhe përfaqësuesve të misionëve dhe institucioneve ndërkombëtare.

Atëherë në Prizren e kuptuam që takimet e shumta të mëparshme nuk kanë qenë të kota dhe se të gjithëve, si familjarë të viktimave në Kosovë nga të gjitha komunitetet etnike, na është dashur që të kalojmë një rrugë të gjatë e me gjemba, për t'u liruar nga paragjykimet për fajin kolektiv të një populli të tërë. Procesi i ballafaqimit me të vërtetën ka zgjatur me vite por vendosmëria jonë dhe këmbëngulja për të qëndruar në atë rrugëtim, na kanë bërë akoma më të fortë që të flasim me një zë, edhe pse ne gjuhë të ndryshme, që dëgjohej më fort sesa apelet dhe kërkesat individuale për të gjetur të gjithë të zhdukurit dhe për të proceduar dhe dënuar drejt të gjithë ata që janë përgjegjës për vuajtjen tonë si familjarë dhe të të afërmve tanë.

Takimi i familjeve serbe dhe shqiptare të të zhdukurve në Prizren, mars 2015.

Millorad Trifunović, Vushtrri

PA DHËNË MOSTRA TË GJAKUT, NUK KANË PËR T'U GJETUR TË ZHDUKURIT

Një nga problemet e mëdha që nuk kemi arritur ta zgjidhim deri më sot janë identifikime të gabuara. Gjatë vitit 1999 janë varrosur 2000 persona me metodë klasike të identifikimit, pa bërë analiza të ADN-së. Të gjithë ata, përveç një personi, ishin të kombësisë shqiptare. Vetëm nëntëdhjetë përqind të anëtarëve të familjeve që kanë raportuar zhdukjen e të afërmve të tyre, kanë dhënë gjak për analiza të ADN-së. Shoqatat serbe dhe shqiptare të të zhdukurve kanë bërë përpjekje që t'u shpjegojnë këtyre familjeve rëndësinë e dhënies së mostrës së gjakut, pa të cilën as nuk mund të shpresojmë që do të zbulohet e vërteta për të zhdukurit në Kosovë. Në morgun e spitalit të Prishtinës gjenden mbetjet e rreth katërqind trupave ende të paidentifikuar. Përveç kësaj, shumë lokacione të shënuara si potenciale kanë mbetur të pakërkua ose të kërkuara pamjaftueshëm. Meqë i dimë të gjitha këto, jemi pothuajse të sigurt që çështjen e gjetjes së të zhdukurve në Kosovë do t'ua lëmë si barrë gjeneratave të reja me shpresën që do të zgjidhen sa më shumë raste të të zhdukurve. Pikërisht për këtë arsye përfshijmë sa më shumë të rinj në punën e shoqatave tona, duke qenë të vetëdijshëm se janë ata të cilëve po ua kalojmë këtë barrë të rëndë që po mbartim ne me vite të tëra.

(Shënimi i përbashkët i Ditës së të Zhdukurve, Prishtinë 2018)

IN MEMORIAM

Nuri Damati, Mitrovicë

DUKE MOS E HARRUAR TË KALUARËN, SYNOJMË NJË TË ARDHME MË TË MIRË

Punëtorja me të rinjtë nga shoqatat serbe dhe shqiptare të të zhdukurve në Novi Pazar, shtator 2022

Anëtarët më të rinj të familjeve serbe dhe shqiptare të të zhdukurve janë takuar për herë të parë gjatë punëtorisë në Novi Pazar. Ishte një përvojë e re për të gjithë ne. Fillimisht e kuptuam këtë përmes komunikimit të ndërsjellë, që shumica prej nesh ishim skeptikë për mundësinë që të planifikojmë aktivitete të reja. Të ndarë në dy grupe të përziera, e tejkaluam shumë shpejt barrierën e mosnjohjes së gjuhës së moshatarëve tanë, duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë që pritet nga ne të rinj, dhe kryesisht të udhëhequr nga dëshira për të ecur më shpejt drejt mirëkuptimit reciprok. Duke kujtuar të kaluarën dhe duke dëshiruar një të ardhme më të mirë. Ia propozuam organizatorit të takimit (UNDP) idetë tona për punën tonë të mëtejshme. Formuluam dhe parashtruam problemet, pyetjet dhe temat që duam t'i shndërrojmë në projekte të përbashkëta të bazuara në qëndrimet e barabarta, duke respektuar diferencat.

Pas punëtorisë në Novi Pazar, ndoshta me vonesë, e kuptuam që barra e çështjeve të pazgjidhura do të mbetet në gjeneratën tonë me pjesëmarrjen dhe mbështetjen e anëtarëve me më shumë përvojë.



Jelena Vujnoviq, Prishtinë

QASJA E ANËTARËVE TË RINJ, DREJTIMI I RI I VEPRIMIT TË PËRBASHKËT

Punëtorja me të rinjtë nga shoqatat serbe dhe shqiptare të të zhdukurve në Novi Pazar, shtator 2022.

Kur përfunduan konfliktet e armatosura në Kosovë, shumica nga ne, anëtarë të rinj të shoqatave shqiptare dhe serbe të familjeve të viktimave civile që kishim mbetur pa të afërm, nuk ishim lindur akoma ose ishim fëmijë. Për tmerret dhe pasojat e këtyre konflikteve dinim vetëm atë që na kanë treguar prindërit, ose atë që mësonim në shkollë.

Dinim pak por mjaftueshëm për të krijuar paragjykime se vetëm njëra anë ka bërë krime në luftë dhe se ka pasur viktime ndër civilë vetëm në njërën anë. Dhe me këtë lloj ndjenje jemi rritur ne në Prishtinë, Mitrovicë, si dhe bashkëmoshatarët tanë në Beograd.

Rreth dhjetë vitesh më parë kemi filluar të përfshiheshim në punën e shoqatave të familjeve të të zhdukurve të cilat tashmë kishin filluar të krijonin bashkëpunim dhe të vepronin së bashku, gjë që na ka ndihmuar që të marrim një ide më të gjerë dhe më të qartë për këto kohëra të liga.

Në fillim ishim vetëm vëzhgues të heshtur dhe dëgjonim me vëmendje se si dhe për çfarë flasin anëtarët më të moshuar të familjeve shqiptare dhe serbe të viktimave.

E pamë dhe e kuptuam pas nja dhjetë takimeve të përbashkëta në Nish, Prizren, Beograd... se ata flisnin gjuhë të njëjtë. Gjuhën e trishtimit dhe dhimbjes. Gjuhën e dëshpërimit dhe pakënaqësisë që përgjegjësit nuk e trajtojnë çështjen e të zhdukurve si çështje humanitare, por politike. Prandaj dhe rezultatet e mosinteresimit të tyre për të gjetur të zhdukurit deri te i fundit janë pothuajse të padukshme.

Në punëtorinë e parë në Novi Pazar që ka mbledhur anëtarë të rinj të familjeve nga të gjitha komunitetet etnike filluam të flisnim me një zë edhe ne, që s'kemi komunikuar shumë me njëri-tjetrin deri dje. Ashtu siç komunikojnë me vite të tëra kushërinjtë tanë më të moshuar, duke pasur dëshirë për të përshpejtuar procesin e zbulimit të së vërtetës për të gjithë të zhdukurit në Kosovë. Kemi punuar në grupe të përziera etnikisht. Edhe pse disa prej nesh flisnin vetëm gjuhën serbe ose vetëm gjuhën shqipe, kurse shumica dinin dhe anglishten, shumë shpejt arritëm të kuptohemi dhe të sugjerojmë drejtimet e mëtejshme të veprimit tonë.



Stefan Shqepanoviq, Osojan

AS VIKTIMA, AS KRIMINELI, NUK KANË KOMBËSI

Nuk duhet të ketë më standarde të dyfishta dhe ndarje në viktimë më shumë dhe më pak të rëndësishme. Viktima nuk ka kombësi dhe nëse vazhdon ky lloj animoziteti, do të jetë krim i përsëritur. Për këtë arsye duhet të ushtrojmë presion së bashku ndaj institucioneve në Beograd dhe Prishtinë me qëllim të hapjes së arkivave. Por edhe të arkivave perëndimore. Sigurisht, për këtë duhet të ketë vullnet politik. Pa këtë nuk do të mund të hyjmë sistematikisht në zgjidhjen e problemit të të zhdukurve dhe të varrëve. (Vrnjačka Banja, viti 2022)

Budimir Maslar, Pejë

VEPRIMET E PËRBASHKËTA TASHMË SJELLIN REZULTATE

Kanë kaluar shumë takime dhe vite ku ne, përfaqësues të familjeve serbe të të zhdukurve, dhe bashkëvuajtësit tanë Shqiptarë kemi shikuar njëri-tjetrin, duke mos e kuptuar që, në fakt, po flisnim të njëjtën gjuhë. Gjuhën e trishtimit, dhimbjes, dëshpërimit dhe, me sa duket, të shpresës së kotë që do t'i gjejmë të zhdukurit tanë ndonjëherë. Me kohën dhe këmbënguljen për t'u "mbajtur bashkë", e kuptuam që të gjithë ata kanë një emër, pavarësisht nëse janë Serbë, Shqiptarë apo tjetër... Përderisa nuk dihet asgjë për ta, derisa familjet e tyre të marrin mbetjet e tyre mortore në mënyrë që ti varrosin me dinjitet, të gjitha ata kanë emër të përbashkët. Të gjithë ata quhen njësoj - "të Zhdukurit". Dhe janë shumë. Prandaj nuk heq dorë nga kërkimi për të vërtetën rreth viktimave të Kosovës, por edhe i motivoj anëtarët e rinj që të vazhdojnë betejën tonë.

Negovan Mavriq, Hoçë e Madhe

T' U SHPJEGOJMË TË RINJVE ÇKA NA KA NDODHUR NË TË KALUARËN

Negovan Mavriq, njëri nga themeluesit e Qendrës Burimore Multietnike për Personat e Zhdukur në Prishtinë, gjatë takimit të mbajtur në Prishtinë të Shoqatës së Familjeve të Viktimave të Kosovës dhe përfaqësuesve të Qendrës Burimore, theksoi: -"Qendra Burimore Multietnike për Personat e Zhdukur në Prishtinë ka arritur të bëjë atë që mendohej e pamundur, të bashkojë familjet e të zhdukurve dhe të varrëve në Kosovë, të kombësive të ndryshme, të cilat së bashku kërkojnë zgjidhje për përshpejtimin e zbulimit të së vërtetës për të gjithë personat e zhdukur në Kosovë. Për pesë vjet sa ekziston Qendra Burimore, mbi dymijë anëtarë kanë kaluar nëpër këtë organizatë. Mbi 700 takime janë mbajtur, dhe kurrë nuk është shënuar asnjë incident. Këtu janë takuar Romë, Ashkalinj, Serbë, Shqiptarë... Një nga qëllimet tona më të rëndësishme është që t' u shpjegojmë të rinjve se çka ka ndodhur në të kaluarën, në mënyrë që të mos përsëritet më ajo që kemi përjetuar".

FALË TYRE, NJOHËM DHE PRANUAM PIKAT
E KONTAKTIT, DHE SHPËRFILLËM PIKAT E NDARJES



JANË RRËMBYER SEPSE QUHESHIN UKSHIN, ANDRIJA, OSMAN, MILAN.

..

Gjithmonë më trondisin fjalimet e familjarëve. Nuk është e lehtë të jesh nëpunës shteti nga i cili pritet që të bëjë punën e tij edhe pse ai has në pengesa në shumë situata. Është pakrahueshmërisht më e vështirë të jesh njëri nga familjarët e të rrëmbyerve, që njëzetetë vjet. Në maj të atij viti të largët 2000 u bëra anëtare e shoqatës edhe pse nuk kam pasur ndonjë të afërm të zhdukur. Në atë vit të largët 2000 u mendova se si do të ishte sikur fëmijët e mi të zhdukeshin për një orë të vetme, ose prindërit e mi, vëllai, motra dhe aty e kuptova se ju e keni shumë të vështirë dhe se ne duhet t'ju rrimë pranë dhe t'ju ndihmojmë sa të mundemi... dhe ja, pas 23 vitesh jemi prapë në të njëjtin vend, rezultate të pritura nuk kemi, por jemi bashkë. Pavarësisht se çka kemi dhe nuk kemi arritur, do të vazhdojmë të flasim dhe të shkruajmë për këtë problem, sepse vetëm kështu do të zgjidhet çështja e të zhdukurve, nëse procesi i gjurmimit mbetet i gjallë dhe nëse përmenden çdo ditë 1630 familje që kanë humbur më të dashurit e tyre. Nuk jam duke thënë ndonjë gjë të re kur sot, në ditën e të Drejtave të Njeriut, po ju them se të gjitha të drejtat e të rrëmbyerve në Kosovë dhe të familjeve të tyre janë shkelur dhe po shkelen deri më sot. Është listë e gjatë e të drejtave të njeriut që përmban Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut. Së pari, e drejta për jetë, ndalimi i torturës, e drejta për liri dhe siguri, e drejta për gjykim të drejtë, e drejta për barazi, e drejta për kombësi, e drejta për lëvizje të lirë dhe të të drejtat e tjera, dhe janë shkelur të gjitha. E drejta për lëvizje të lirë - janë ndaluar në rrugën ku gjithmonë lëviznin lirshëm. Por në një moment, dikush ia dha vetes të drejtën për të ndaluar dike dhe për ta rrëmbyer atë vetëm për shkak të kombit apo fesë tjetër. Janë rrëmbyer sepse quheshin : Ukshin, Andrija, Osman, Milan, Sinan, Dragan... Nuk kanë marrë gjykim të drejtë, janë vrarë dhe torturuar, u është mohuar e drejta për jetën. Çështja e të zhdukurve na kujton gjithmonë se derisa të mbetet e pazgjidhur, ne po pyetemi nëse kemi ndonjë të drejtë fare. Çdo e drejtë shoqërohet dhe nga detyra e caktuar. Problemi i të zhdukurve dhe të të drejtave të familjeve të tyre nuk mund të mbeten ende në margjinat e interesimit të publikut dhe të autoriteteve. Që të takohemi çdo tre, katër muaj, në rastin më të mirë, dhe vetëm atëherë të flasim për personat e zhdukur. Ne që merremi me të drejtat e personave të zhdukur në cilëndo mënyrë, e kemi për detyrë që t'u japim zë atyre që e kanë humbur atë përgjithmonë dhe në emër të të cilëve po luftojmë pa u lodhur, pavarësisht viteve që lamë pas dhe viteve gjatë të cilëve do të vazhdojmë të merremi bashkërisht me këtë çështje. Të rrëmbyerve u ka ngelur vetëm një e drejtë e fundit, për t'u prehur me dinjitet në vendin ku meritojnë paqe të përfjetshme. Me e lehtë është të heqësh dorë, të ndalosh procesin. Në prill do të bëhen tre vjet pa u takuar delegacionet e Beogradit dhe Prishtinës në kuadër të grupit të punës që ka mandatin e vetëm që të merret me personat e zhdukur. As apelet e familjeve, as qëndrimi i komunitetit ndërkombëtar, nuk kanë dhënë rezultat të duhur. Po të kishte dashur, komuniteti ndërkombëtar me shumë

mundësi do ta kishte parandaluar konfliktin edhe para se të ndodhej. Bajrami kërkon djalin, Natasha nënën, Gjyla bashkëshortin, Budo kërkon motrën, Slavi dhe Smiljka-prindërit... Kush ka të drejtë që t'ua marrë të vërtetën dhe drejtësinë?

Ajo që apelojmë të gjithë ne këtu është zhblllokimi emergjent i procesit dhe largimi i politikës nga kjo çështje humanitare. Tani presin nga unë që të them diçka të re. Kohët e fundit, ndoshta u bëra pak optimiste. Ajo që mund t'ju them është se pas tre vitesh bllokim, më 31 janar të vitit 2024 do të mbahet seanca e grupit të punës ku do të flitet për lokacionet që duhen kërkuar, për arkivat, identifikimet, do të shkëmbejmë informacione rreth lokacioneve, do të përcaktohet dhe afati kohor për zbatimin e këtyre aktiviteteve. Ne, si Komision nuk e kemi ndalur punën, por arritëm të gjejmë informacione rreth gati njëzet lokacioneve. Gjëja e parë që do bëjmë është të kërkojmë nga Prishtina që të kërkojnë këto lokacione potenciale. Komisioni në Beograd, si dhe ai në Prishtinë, më siguri mund të kishin bërë më mirë dhe më shumë. Edhe pas kësaj dite dhe pas këtij takimi me ju, do të mendohemi se çfarë mund të bëjmë më shumë. Unë ju kërkoj ndjesë që nuk kam diçka të re për t'ju thënë. Ndonjëherë i them vetes se kam turp para familjeve, por po të varej vetëm nga ne, me siguri do të kishim bërë më shumë.



Nga tryezat e rumbullakëta të mbajtura në Vrdnik, Nish dhe Vrnjačka Banja, organizatorët, si dhe familjet serbe dhe shqiptare të të zhdukurve në Kosovë u kanë dërguar një mesazh dhe kërkesë të fortë atyre nga vullneti i të cilëve varet ndriçimi më i shpejtë i së vërtetës për të zhdukurit.

“HAPNI ARKIVAT, SHKËMBENI INFORMACIONET DHE GJENI TË ZHDUKURIT”

Urosh Mamiq (Ambasada e Britanisë së Madhe në Beograd):

Mbështesim të gjitha format e veprimit tuaj të përbashkët

–„Mbështesim takimet siç është ky si dhe të gjitha format e veprimit të përbashkët nga të cilat u dërgoni të njëjtin mesazh të fortë autoriteteve dhe institucioneve se jeni duke pritur një bashkëpunim më të frytshëm nga ata. Të qenit i vetëdijshëm për faktin që institucionet duhet të jenë dhe janë shërbimi i qytetarëve është diçka që unë e dëgjoj nga fjalimet tuaja. Në kuptimin e përgjegjësisë për punën e tyre ndaj qytetarëve, si tatimpagues - si pjesë e sistemit që financon punën e këtyre institucioneve. Pikërisht për këtë arsye, edhe ju keni të drejtë të kërkonit raporte për punën e tyre, për përmirësimin e metodave dhe mënyrave të komunikimit me qëllim të zbardhjes më të shpejtë të së vërtetës për të zhdukurit tuaj. Për këtë arsye, duhet të pritet një bashkëpunim më i mirë me ta, kështu që po ju ftoj që të insistoni për këtë. Në këtë rast, të kërkonit zgjidhjen e fateve të më të afërmeve tuaj. Kjo u jep legjitimitet pritshmërive dhe kërkesave tuaja ndaj tyre dhe siguron praninë e institucioneve që punojnë për ju. Ju ftoj që të shfrytëzoni fuqinë dhe legjitimitetin e kërkesës suaj për të bërë thirrje për prezencë të përfaqësuesve të institucioneve të cilat ju përfaqësojnë juve. Kjo nuk është legjitimitet dhe mandat i organizatave ndërkombëtare. Ky është mandati juaj si përfaqësues të shoqërisë civile, për të përforcuar lidhjet midis Beogradit dhe Prishtinës.

Duam që të ndërtoni një të ardhme më të mirë dhe sigurisht që jeni në rrugën e duhur. Partneriteti juaj dërgon një mesazh të qartë që puna e përbashkët është rruga e duhur drejt zgjidhjes më të shpejtë të problemeve. Ne jemi këtu që t’ju mbështesim dhe mbetemi të përkushtuar që t’ju mbështesim që të këmbëngulni në përpjekje të përbashkëta që të mësohet fati i të gjithëve nga lista e personave të zhdukur”.

Ivan Jovanović (UNDP)

Mesazhet tuaja të përbashkëta kanë fuqi të madhe

–„E identifikua nevojën dhe vendosmërinë tuaj që të dërgoni mesazh të fortë përmes daljeve publike, se nuk do të hiqni dorë nga kërkesat që të gjenden të gjithë të zhdukurit. Duam t’ju ndihmojmë që t’u komunikoni të gjitha institucioneve, organeve dhe organizatave konkluzionet që do të merren këtu, që i referohen mandatis dhe detyrave të tyre, kur bëhet fjalë për të zhdukurit, si dhe mediave. Mesazhi juaj ka fuqi të madhe. Askush nuk mund të mbetet imun kur të marrë mesazhin unik të shkruar nga

familjet e viktimave shqiptare dhe serbe.

Mungesa e komunikimit të mirë dhe shkëmbimi i informacioneve midis Beogradit dhe Prishtinës është segmenti më i rëndësishëm të cilin e përmendni gjithmonë si pengesë për gjetjen më të shpejtë të të gjithë të zhdukurve. UNDP në Bosnjë Hercegovinë pati një përvojë të mirë me organizimin e takimeve të familjeve të të zhdukurve nga niveli lokal me Prokurorinë, prokuroritë të entiteteve dhe policinë... Gjatë këtyre takimeve, jo vetëm që familjet e të zhdukurve kanë mësuar informacione të shumta nga institucionet shtetërore por edhe anasjelltas - institucionet shtetërore kanë mësuar shumë informacione të reja dhe të rëndësishme nga shoqatat e familjeve të viktimave. Jemi të gatshëm që t'ju mbështesim dhe t'ju ndihmojmë që të realizoni këtë lloj komunikimi dhe shkëmbimi të informacioneve dhe të ndikoni drejtpërdrejtë në gjetjen e varrezave masive, ekshumime të reja dhe identifikime”.

Fransis Pikap, përfaqësuesja e përhershme e UNDP-së në Serbi:

Mostrimi pasiv do të heqë gabime të mundshme

Në kuadër të projektit “Përmirësimi i kërkimit për personat e zhdukur në Republikën e Serbisë” i cili zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe financohet nga Qeveria e Britanisë së Madhe, nga data 17 deri më 20 tetor të vitit 2019 në Vrdnik është organizuar punësoria e mbështetjes së shoqatave të familjeve të personave të zhdukur gjatë konflikteve në territorin e ish-RSFJ-së gjatë viteve nëntëdhjetë

-“Problemi i identifikimeve të gabuara me metodë klasike që është përdorur para themelimit të analizave të ADN-së nga ana e ICMP-së, imponon nevojën që të zgjidhen të gjitha rastet e tilla përmes mostrimit të përsëritur të gjakut ose marrjes së tamponave nga familjarët e të zhdukurve. Në dakordësi dhe me pëlqim të institucioneve që merren me këtë, rolin kuç dhe të pazëvendësueshëm e luajnë shoqatat ekzistuese të Serbëve dhe Shqiptarëve të zhdukur. UNDP ka mbështetur dhe do të mbështesë institucionet dhe të gjithë që merren me çështjen e të zhdukurve, me qëllim që të gjendet dhe të identifikohet numri sa më i lartë i të zhdukurve. Është shumë e mirë dhe e rëndësishme që të bashkëpunojnë familjet e të zhdukurve të të gjitha komuniteteve etnike, por është e domosdoshme që të bashkëpunojnë edhe institucionet. Sepse, shkëmbimi dhe zbardhja e informacioneve, me doemos, do të kontribuonte në përshpejtimin e procesit, ndërsa rezultati - rritja e konsiderueshme e numrit të identifikimeve, nuk do të mungonte. Kjo do të nënkuptonte dhe qasje më të madhe në drejtësi”.

Frensis Pikap apeloj për miratimin e Ligjit për Personat e Zhdukur në Serbi, i cili tashmë ekziston në shtetet në rajon, në mënyrë që familjet e të zhdukurve të mund të realizojnë të drejtat e tyre.

Sekretarja e Parë e Ambasadës Britanike në Beograd, Shantell Ker :

Të humbasësh dikë tëndin në luftë, krijon dhimbje më të thellë

-,Mendojmë që zgjidhja e çështjes së të zhdukurve është një kusht i domosdoshëm për pajtim dhe normalizim të plotë të marrëdhënieve midis vendeve të rajonit. Lufta dhe shkatërrimet e luftës janë një përvojë e tmerrshme për ata që kanë qenë të ekspozuar ndaj tyre. Të humbasësh dikë tëndin në luftë, krijon dhimbje më të

thellë. Besoj se është akoma më e dhimbshme të mos mësosh fatin e më të dashurve të tu. Dhe prandaj, përderisa ekziston dyshimi se dikush nuk dëshiron të zbulojë se ku gjenden të zhdukurit, nuk mund të themi se pasojat e konflikteve të luftës janë rregulluar. Pajtimi i vërtetë dhe shërimi i plagëve që sjell lufta është një proces i gjatë dhe i vështirë. Kurrë dhe në asnjë vend të botës nuk ka qenë e lehtë të hiqen të gjitha pasojat e konflikteve të luftës. Mund të thuhet se është pothuajse më e lehtë të arrish marrëveshje politike të pajtimit. Madje edhe kur të arrihet ndonjë marrëveshje midis politikanëve, për dikë që ka humbur familjarë ose që nuk di gjë për fatin e më të afërmeve të tij, kjo s'i hyn shumë në punë. Është shumë e vështirë të shërosh plagët e familjarëve që kanë humbur njerëz të dashur, por akoma më shumë të atyre si ju, që me vite, tanimë dhe me dekada të tëra, nuk dinë asgjë për fatin e të afërmeve të tyre. Dua t'ju siguroj se do të mbetemi të përkushtuar të gjitha proceseve që sjellin drejtësi për të gjithë ata viktimat të pafajshme të konflikteve të luftës. Për këtë na duhet përpjekja e sinqertë, si të qeverive, ashtu edhe të komuni-teteve më të gjera - që të bëhet çmos në tentativë për të gjetur të zhdukurit dhe për të dënuar autorët e krimeve. E di që kjo nuk e zbut dot dhimbjen tuaj, por përvoja e shumë konflikteve të luftës ka treguar që kujdesja për përkujtimin e viktimave të pafajshme dhe respekti i komunitetit të gjerë ndaj tyre të sjell një lloj lehtësimi. Është shumë më e dhimbshme kur të zhdukurit tuaj harrohen nga komuniteti i gjerë. Do të vazhdojmë të mbështesim luftën e përbashkët të familjeve të të zhdukurve drejt pajtimit të vërtetë dhe shërimit të plagëve të luftës. Por edhe durimin dhe këmbënguljen tuaj gjithashtu, sepse ky proces me shumë mundësi do të zgjasë edhe shumë.

Jasna Hajder (UNDP):

Roli i shoqatave është i pazëvendësueshëm

-”Në procesin e zbardhjes së fateve të të zhdukurve në Kosovë, rolin kyç dhe të pazëvendësueshëm e luajnë shoqatat ekzistuese të Serbëve dhe Shqiptarëve të zhdukur që kanë komunikim të mirë si dhe bashkëpunim të suksesshëm. UNDP ka mbështetur dhe do të mbështesë institucionet dhe të gjithë që merren me çështjen e të zhdukurve, me qëllim që të gjendet dhe të identifikohet numri sa më i lartë i të zhdukurve. Është shumë e mirë dhe e rëndësishme që të bashkëpunojnë familjet e të zhdukurve të të gjitha komuniteteve etnike, por është e domosdoshme që të bashkëpunojnë edhe institucionet. Sepse, shkëmbimi dhe zbardhja e informacioneve, me doemos, do të kontribuonte në përshpejtimin e procesit, ndërsa rezultati - rritja e konsiderueshme e numrit të identifikimeve, nuk do të mungonte. Kjo do të nënkuptonte dhe qasje më të madhe në drejtësi”. Dua të apeloj edhe për miratimin e Ligjit për Personat e Zhdukur në Serbi, i cili tashmë ekziston në shtetet në rajon, në mënyrë që familjet e të zhdukurve të mund të realizojnë të drejtat e tyre”.

Jelena Stijaçiq, shefe e Delegacionit të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, Beograd:
Punë e vazhdueshme në përshpejtimin e procesit të gjetjes së të zhdukurve

Vazhdon mbështetja e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq për familjet e personave të zhdukur në Kosovë. Në takimin e Delegacionit të KNKK Beograd me familjarët e të zhdukurve në Kosovë u bisedua edhe për statusin aktual të dosjeve të të zhdukurve, si dhe për aktivitetet që ndërmerr KNKK lidhur me zgjidhjen e

çështjes së zbardhjes së fateve të të zhdukurve në Kosovë

- "Kemi mbi njëzet vjet që njihemi dhe jemi shokë dhe askush nga ne nuk e besonte se ky proces do të zgjaste kaq shumë dhe se do të ishte kaq i dhimbshëm. Kaq shumë po zgjat kjo luftë e gjatë dhe këmbëngulëse dhe aktivitete të panumërta të KNKK-së dhe të familjeve të të zhdukurve për gjetjen e numrit sa më të lartë të të zhdukurve. Megjithatë, rezultatet nuk janë proporcionale me përpjekjet e investuara, duke marrë parasysh numrin e rasteve të pazgjidhura, sidomos gjatë viteve të fundit. Arsyeja e kësaj është, mbi të gjitha plogështia, mungesa e iniciativave nga ata të cilët duhet t'i përkushtohen me sinqeritet zgjidhjes së çështjes së të zhdukurve. Është fakt që procesi është politizuar dhe pothuajse është ndalur.

Si të jetojmë me humbjen dhe kujtimin për të zhdukurit? Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq ka vazhduar të ndihmojë familjarët e të zhdukurve edhe përmes mbështetjes psikosociale. Mbështetja nënkupton punë me familjet në lidhje me vazhdimin e jetës pas humbjes, si dhe zhvillimin e kujtimit të familjarëve të zhdukur por edhe përfaqësimin e tyre para këtij komuniteti në mënyrë që të tregohet se ata kanë pasur emra, por edhe karakter. Se ata kanë qenë pjesëtarë model të komunitetit tonë, njerëz të dashur, me punët dhe hobiet e tyre, që thjesht kanë ekzistuar në këtë shoqëri, jo vetëm si numra statistikorë", theksoi Jelena Stijaçiq.

Humanist dhe intelektual me qëndrim - Bekim Blakaj, drejtor i Fondit për të Drejtë Humanitare të Kosovës

Të gjithë akoma numërojnë vetëm viktimat e veta

Njëzetedy vjet pas përfundimit të luftës në Kosovë, dhe ende numërohen vetëm viktimat e njërrës pale, duke mohuar dhe shpërfillur viktimat e palës tjetër. Në këtë mënyrë po krijohen narrative të njëanshëm. Gjeneratat e reja të Serbëve dhe Shqiptarëve kanë mendime tërësisht të kundërshtuara për atë që ka ndodhur 22 vite më parë. E drejta e viktimave për drejtësi dhe e drejta e familjeve të tyre për të vërtetën është me rëndësi kyçe, por deri tani ishte e pamundur që autorët të përgjigjen për pabërat e tyre. Për të dy shoqëri, viktimat dhe familjet, është e rëndësishme të paktën t'i pranojmë viktimat dhe dhimbjen e tyre. Gjëja më e keqe është nëse ende vazhdojmë të mohojmë viktimat nga komunitetet e tjera etnike. Sepse, në ca rrethana të tjera, për fat të keq, mund të arrijmë në përsëritje të konflikteve. Në këtë moment besoj se problemi kyç është që nuk ka vullnet politik për zgjidhjen e këtij problemi, pavarësisht se institucionet e Kosovës dhe të Serbisë e thonë në mënyrë deklarative se çështja e personave të zhdukur shihet vetëm si çështje humanitare. Prapë se prapë, duhet të them se politikanët në Prishtinë dhe Beograd e shohin çështjen e të zhdukurve vetëm si çështje politike, gjë që e shpjegon dhe arsyen e ndalimit të procesit të gjetjes të të gjithë të zhdukurve.



FJALËT DHE APELET E PËRBASHKËTA DËGJOHEN MË FORTË DHE ARRIJNË MË LARG

Çerek shekulli më vonë, familjet e të zhdukurve nga të gjitha komunitetet etnike dhe të viktimave gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë, po jetojnë ditët e dhunës, vuajtjes dhe mospërballimit. Sidomos ato që ende nuk kanë mësuar fatin e më të afërmeve të tyre të cilët nuk i kanë varrosur akoma dhe kanë frikë se nuk do ta presin atë ditë

Duke kaluar këtë rrugë shumëvjeçare, aspak të lehtë, drejt përmirësimit të mirëkuptimit, mësuam të dëgjojmë njëri-tjetrin, të respektojmë trishtimin dhe dhimbjen e të tjerëve, të bashkëndiejmë me secilin që jeton me traumë për shkak humbjes së personit të dashur, të çfarëdolloj feje apo kombësie qoftë... Të na pikojë ai lot i rëndë i dhembshurisë nga fytyra. Ky mospërballim dhe lufta për të gjetur të gjithë të zhdukur dhe të vrarë, do të zgjasë sa të jemi gjallë. Sot në listën e integruar të personave të zhdukur ende gjenden emrat e rreth 1618 personave, fati i të cilëve nuk është zgjidhur ende. As nuk dihet a janë të gjallë, as nuk u dihet varri. Në laboratorët e analizave të ADN-së, në vend të emrave të tyre qëndron numri dhe kodi. Dhe secilin prej tyre dikush e ka pasur djallë, babë, nënë, motër... Ne, familjarët e tyre, i harxhuam lotët duke qarë gjatë çerek shekullit të fundit. Por nuk u lodhëm duke kërkuar të vërtetën për më të afërmit tanë, duke luftuar për drejtësinë dhe të vërtetën. Sepse ne nuk kemi të drejtë për të harruar. As nuk kemi frikë të themi se kush është fajtor që lista e të zhdukurve mbeti pothuajse “e ngrirë”, që ka gjithnjë e më pak ekshumime dhe identifikime, ndërsa agonia jonë po vazhdon ende. Institucionet ndërkombëtare dhe të huaja kanë mbetur të heshtura. Dështuan në provimin e humanitetit. Janë më përgjegjës që gjatë gjithë viteve të kaluara çështja e personave të rrëmbyer dhe të zhdukur nuk u gjet në tryzën e negociimit të Beogradit dhe Prishtinës në Bruksel. Së fundmi kanë filluar të përmendin të zhdukurit, por jo edhe të kërkojnë në mënyrë të përgjegjshme dhe të sigurt modalitete të përbashkëta në mënyrë që të përshpejtohet procesi i zbardhjes të së vërtetës për fatin e rreth 1618 personave. Të gjithë ata duhet ta kishin kuptuar moti që çështja e të zhdukurve është çështja më e rëndësishme, jo vetëm për ne si familjet e tyre. Është plotësisht e sigurt që pa u zgjidhur fati i çdo personi të rrëmbyer dhe të zhdukur në Kosovë, nuk ka përparim. Nuk ka pajtim as paqe në rajon, dhe të gjithë zyrtarët thonë se kjo është më e rëndësishmja. Prandaj, me të drejtë të plotë po kërkojmë: Bini dakord dhe bëni atë që duhej bërë moti. Hapni arkivat, shkëmbeni informacionet dhe gjeni të gjithë të zhdukurit. Le t’u kthejmë dinjitet të gjithë viktimave të pafajshëm dhe familjeve të tyre!” Gjithmonë pyetemi nga e para: Si ka mundësi që ne, si familjarë të viktimave nga të gjitha komunitetet etnike, arrijmë të ulemi së bashku në një tryezë dhe të bisedojmë dhe të përpiqemi të gjejmë rrugë deri tek ata nga të cilët varet zbardhja e fateve të më të afërmeve tanë. Kurse ata, që gjithsesi nuk kanë viktimë dhe të zhdukur, që nuk kanë as vullnet e as dëshirë, dhe nuk janë të rënduar nga trishtimi, por janë të detyruar që të zgjidhin këto probleme, nuk mund të gjejnë gjuhë të përbashkët dhe të ndërpresin agoninë e familjeve të të zhdukurve, që tashmë zgjat për një çerek shekulli. Ne, familjarë më të moshuar të të zhdukurve, shpresojmë shumë tek ata të cilëve po ua lëmë barrën e zgjidhjes së fateve të të gjithë të zhdukurve. Në këtë luftë të përbashkët për përfshihen gjithnjë e më shumë të rinj që merren vesh më lehtë dhe komunikojnë më kollaj me njëri-tjetrin. Të gjithë së bashku e kemi më të lehtë të përballojmë probleme të grumbulluara dhe të pazgjidhura me mbështetjen dhe ndihmën e disa institucioneve vendase, si dhe të organizatave ndërkombëtare që merren me të zhdukurit dhe çështjet e të drejtave të njeriut. Pa mbështetjen dhe ndihmën e tyre, rezultatet e angazhimit dhe aktivitetit të familjeve serbe dhe shqiptare të të zhdukurve, nuk do të ishin ato që janë sot, dhe që do të jenë në vitet në vijim, shpresojmë.

Jordan Dikavoni

KONKLUZIONET E PËRBASHKËTA, DIKUR

Në nëntor të vitit 2012 në Shkup, Maqedoni e Veriut, u mbajt konferenca për familjet e të zhdukurve nga Kosova me pjesëmarrje të 20 përfaqësuesve shqiptar dhe 20 serb të familjeve të të zhdukurve dhe me institucionet vendase dhe ndërkombëtare.

1 Kosova dhe Serbia duhet të shtojnë përfshirjen e aktiviteteve për grumbullimin e informacioneve rreth lokacioneve të varrezave të fshehura, duke përfshirë edhe rishikimin e të gjitha arkivave dhe mundësinë e përdorimit të imazheve satelitore dhe të mjeteve të tjera në dispozicion/metodave bashkëkohore në mënyrë që të përmirësohen aktivitetet në terren, pra gërmime dhe ekshumime në bashkëpunim me komunitetin ndërkombëtar.

2 Çështja e varrezave të lidhura me konfliktin në Kosovë, por që gjenden jashtë territorit të Kosovës, duhet të zgjidhet bashkërisht nga institucionet relevante të Prishtinës dhe Beogradit në bashkëpunim me komunitetin ndërkombëtar.

3 Për arsye të ndryshme, duke përfshirë dhe faktin që njerëzit janë zhdukur përmes kufijve gjeopolitike, duhet të shqyrtohet në mënyrë të detajuar mundësia për krijimin e një liste të personave të zhdukur në konfliktet në zonën e ish-Jugosllavisë nga fundi i shekullit të 20 - e cila duhet të përfshijë edhe listën e konsoliduar të personave të zhdukur nga Kosova.

4 Është tepër herët që të flitet për memoriale dhe ceremoni përkujtimore të përbashkëta?

5 Të sigurohet edukimi për familjet e të zhdukurve rreth përdorimit të mundësive ligjore në realizimin e qasjes në informacione me interes publik me qëllim të grumbullimit të informacioneve për personat e zhdukur dhe varreza të fshehura.

6 Duhet të plotësohen të gjitha parakushtet që të veprohet në bazë të parimeve ligjore, që thonë se autorët duhet të gjykohen në vendet ku janë kryer krimet.

7 Të përmirësohet programi i mbrojtjes së dëshmitarëve, duke marrë parasysh edhe ndikimin e mundshëm që mund të ketë dëshmia në gjetjen e lokacioneve të varrezave masive me mbetjet mortore të personave të zhdukur.

8 Të nisët dialogu për çështjen e personave të zhdukur midis institucioneve kompetente të Beogradit dhe Prishtinës në Bruksel, nën kujdestarinë e Bashkimit Evropian.

9 Të mbështetet themelimi i një ekipi të përbashkët operacional me detyrë për të zgjidhur çështjen e personave të zhdukur, i cili do të përfshinte anëtarët e komisioneve për personat e zhdukur të Kosovës dhe të Serbisë.

10 Prania e ICMP-së duhet të vazhdojë pas mandatit të EULEX-it që skadon në vitin 2014.

11 Rishikimi i identifikimeve para përdorimit të ADN-së.

Shkup, nëntor 2012

KONKLUZIONET E PËRBASHKËTA, SOT

Edhe pse propozimet dhe kërkesat që familjet serbe dhe shqiptare të të zhdukurve u kanë dërguar autoriteteve në Beograd dhe Prishtinë në çdo takim nuk kanë marrë kurrë përgjigje, apelet dhe lutjet e tyre nga çdo takim i përbashkët shkojnë në drejtim të atyre nga cilët varet zgjidhja e çështjes së të zhdukurve.

1 Thirren përfaqësuesit e institucioneve kompetente vendase që të përforcojnë konsiderueshëm vullnetin politik, si dhe përpjekjet teknike dhe të tjera në zgjidhjen e fateve të të zhdukurve, duke përfshirë edhe bashkëpunimin e pjesëmarrësve përmes mekanizmit të Grupit për Personat e Zhdukur.

2 Kjo nënkupton domosdoshmërinë e hapjes së arkivave tona, por edhe përforcimin e kapaciteteve profesionale dhe teknike, në përputhje me Deklaratën e Përbashkët për Personat e Zhdukur nga Samiti i Londrës për Ballkanin Perëndimor nga viti 2018 dhe dokumentet e tjera të nënshkruara.

3 Familjet e ftojnë bashkërisht Grupin për Personat e Zhdukur, dhe sidomos institucionet kompetente vendase, që të merren vesh për publikimin e Databazës Rajonale të të Dhënave për Personat e Zhdukur.

4 Familjet e ritheksojnë bashkërisht që zgjidhja e çështjes së të zhdukurve nuk duhet të politizohet, që procesi i zbulimit të së vërtetës po zgjat tepër shumë dhe se të gjithë ata kanë po aq të drejtë për zgjidhje më të shpejtë të fateve të të zhdukurve - të më të afërmit të tyre. Institucionet që merren me çështjen e të zhdukurve e kanë po aq detyrë të bëjnë gjithçka brenda kompetencave të tyre që t'u përmbushin këto të drejta familjeve.

5 Zgjidhja e fatit të të zhdukurve duhet të bëhet pjesë e pandashme dhe një nga prioritetet e dialogut të Brukselit, dhe familjet duhet të njoftohen rregullisht mbi marrëveshjet që do të arrihen gjatë dialogut të Brukselit në lidhje me masat që do të ndërmerren me qëllim të zgjidhjes së fatit të të zhdukurve.

6 Thirren shtete që kanë pasur kontigjentët e tyre në përbërje të KFOR-it dhe të misionëve të tjera ndërkombëtare, si dhe organizatat ndërkombëtare që kanë qenë të pranishme në terren, që t'u mundësojnë institucioneve kompetente vendase dhe ndërkombëtare qasje në dokumentet nga arkivat e tyre dhe informacionet që mund të ndihmojnë në përcaktimin e fatit të të gjithë të zhdukurve.

7 Anëtarët e pranishëm të shoqatave të familjeve të të zhdukurve shprehin gatishmëri që, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet kompetente vendase dhe ndërkombëtare, të ndihmojnë në zgjidhjen e problemit të të paidentifikuarve dhe të identifikimeve të gabuara të mundshme. Në rastet kur kjo është e nevojshme, në bashkëpunim me institucionet, do të komunikojmë me familjarët nga zonat e tyre për rëndësinë dhe nevojën për të dhënë mostra gjaku për analizat e ADN-së si dhe për mënyrat e tjera të përshtatshme për zgjidhjen e këtij problemi.

8 Pjesëmarrësit e diskutimit konstatuan se kanë një dhimbje dhe vuajtje të përbashkët, të cilën po e përjetojnë me vite familjarët e të zhdukurve të të gjitha kombësive, duke kërkuar për më të afërmit e tyre. U theksua edhe domosdoshmëria dhe përparësitë e angazhimit të përbashkët dhe të mesazheve të përbashkëta të shoqatave serbe dhe shqiptare dhe të familjeve të të zhdukurve, që mbledhin bashkë familjet, sidomos para institucioneve dhe aktorëve politikë.

9 Pjesëmarrësit ranë dakord në parim dhe prezantuan një sërë idesh për advokimin, veprimin dhe aktivitetet e mëtejshme me qëllim të përshpejtimin të procesit të përcaktimit të fateve të të zhdukurve. Në veçanti kërkohet nga vendimmarrësit vendas politik dhe institucionet që të përmbushin detyrat e tyre për gjetjen më të shpejtë dhe identifikimin e trupave të të zhdukurve, dhe të noftojnë familjarët si dhe publikun mbi këtë.

Vrnjačka Banja, tetor 2021

